

## Terma Reference

### Thirrje për ekspert/ Operator social për ofrimin e shërbimit të kujdesit në familje

<b>Konsulenca</b>	Ekspert/opreator social për ofrimin e kujdesit të shërbimit në familje
<b>Projekti</b>	“Përgjigje ndaj rrezikut të shtuar të abuzimit, shfrytëzimit, trafikimit dhe ndarjes nga familja” zbatuar në partneritet me UNICEF (ALB/PCA202213/PD202359)
<b>Zonat e projektit</b>	Rajonet Tiranë, Durrës
<b>Kohëzgjatja e shërbimit</b>	Qershor 2023 – Shkurt 2024
<b>Lloji i kontratës</b>	Kontratë Shërbimi
<b>Data e fillimit të punës</b>	1 Qershor 2023

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS kërkon të kontraktojë **Operator Social për të ofruar shërbimin e mbështetjes në familje me qëllim rritjen e kapaciteteve të prindërve në drejtim të aftësive për jetën**, në kuadër të projektit “Përgjigje ndaj rrezikut të shtuar të abuzimit, shfrytëzimit, trafikimit dhe ndarjes nga familja” zbatuar në partneritet me UNICEF dhe financuar nga Qeveria Suedeze.

#### Informacion i Përgjithshëm:

**Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS** (shkurtimisht NISMA) është një organizatë jofitimprurëse, e cila është themeluar në shkurt të vitit 2016. NISMA është një aktor jo qeveritar me influencë në sektorin e shoqërisë civile në Shqipëri.

Misioni i NISMA është të ofrojë shërbime dhe zgjidhje të qëndrueshme për individë dhe grupe më të marginalizuara në shoqërinë shqiptare me theks të veçantë në komunitetet Rome dhe Egjiptiane. NISMA advokon dhe lobon në nivel lokal dhe qendror mbi çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve, zhvillimit dhe pjesëmarrjes, përmirësimit të kushteve social-ekonomike të familjeve të tyre dhe fuqizimit të kapaciteteve të shërbimit ofruesve, organizatave jofitimprurëse, profesionistëve dhe aktorëve të tjerë të cilët punojnë me fëmijët në situatë vulnerabël.

#### Përshkrim i projektit:

Projekti ka si qëllim të ofrojë dhe sigurojë mbështetje për sistemin e mbrojtjes së fëmijëve dhe të ofrojë shërbime mbështetëse të integruara për fëmijët dhe familjet në nevojë dhe në nivel të lartë vulnerabiliteti nga abuzimi, shfrytëzimi dhe trafikimi. Projekti fokusohet jo vetëm në mbështetje për fuqizimin e familjeve dhe fëmijëve, por edhe pilotimin e shërbimeve të reja mbështetëse për fëmijën dhe familjen, familjet kujdestare profesionale si dhe ngritja e kapaciteteve për punonjësit që janë pjesë e ofrimit të shërbimeve dhe kujdesit social në kuadër të avancimit të procesit të deinstitutionalizimit.

**Grupet përfituese dhe aktorët kyç:**

- Prindër/ kujdestarë të identifikuar në nevojë për mbrojtje ose në nevojë për referim në shërbimet e kujdesit social;
- Fëmijë të vlerësuar në risk të mesëm ose të lartë ndaj shfrytëzimit, dhunës apo abuzimit;
- Fëmijë të vendosur në shërbimet e përkujdesit shoqëror rezidencial;
- Familje me fëmijë në risk për tu institucionalizuar;
- Punonjës të strukturave vendore, përgjegjës për mirëqenien e fëmijëve;
- Punonjës të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve.

**Eksperti –Operator Social do të jetë përgjegjës:**

Operatori Social merr përsipër të ushtrojë shërbimin e tij/e saj sipas kalendarit të përcaktuar për realizimin e aktiviteteve në funksion të realizimit të objektivave të projektit;

Në këto shërbime përfshihen sipas radhës veprimet si më poshtë:

- a) Hartimi i një kalendarit aktivitetesh ku të përcaktohet qartësisht lloji i aktivitetit, kohëzgjatja dhe rezultatet e pritshme;
- b) Ofrimi i shërbimit cilësor dhe korrekt në raport me nevojat e vlerësuara të familjes;
- c) Kryerja e aktiviteteve që ndihmojnë anëtarët e rritur të familjes të plotësojnë nevojat e tyre themelore, që kanë për qëllim përkujdesin dhe zhvillimin e nivelit të mirëqenies, duke nxitur pavarësinë e tyre;
- d) Bashkëpunimi dhe koordinimi në mënyrë cilësore së bashku me ekipin e projektit të Nisma ARSIS, për të gjitha ndërhyrjet në familjet në Bashkinë Tiranë ose Durrës.

Nën mbështetjen dhe konsultimin me stafin e NISMA, eksperti operator social do të ketë këto përgjegjësi:

- të ndihmojë anëtarët e rritur të familjes në zhvillimin e aftësive për jetën që përfshin kujdesin për higjienën personale, të fëmijëve, banesës dhe ambjentit të përbashkët të jetesës;
- ndihmojë familjen në zhvillimin e aftësive për përmirësimin e mënyrës së të ushqyerit duke përfshirë përzgjedhjen e produkteve të shëndetshme ushqimore dhe gatimin;
- ndihmojë familjen në organizmin e një rutine ditore të shëndetshme që përfshin kohën cilësore të kaluar së bashku
- aftësojë anëtarët e rritur të familjes në menaxhimin e të ardhurave;
- aftësojë anëtarët e rritur të familjes në lidhje me përmbushjen e nevojave zhvillimore të fëmijëve dhe të kujdesit shëndetësor për veten;
- dorëzojë një raport çdo javë në lidhje me ecurinë e kalendarit të aktiviteteve dhe rezultateve të arritura.
- Të mbajë komunikim të rregullt me stafin e NISMA ARSIS dhe të raportojë çdo lloj problematike.
- Të njohë dhe zbatojë me profesionalizëm dokumentacionin e punës së organizatës (rregulloren e brendshme, politikën e mbrojtjes së fëmijëve, politikën e mbrojtjes kundër shfrytëzimit seksual dhe abuzimit, kodin e sjelljes, konventën e të drejtave të fëmijëve dhe çdo dokument tjetër për të cilin duhet të ketë djeni).

**Kualifikimet dhe eksperiencat:**

- Kualifikime në shkencat sociale (punonjës social)

- Kualifikime që lidhen me çështje të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe familjeve
- Të ketë experience pune në shërbimet shoqërore
- Eksperienca të mëparshme në organizata partnere të shoqërisë civile (preferohet)
- Të jetë njohës shumë i mirë i paketës ligjore për politikën e mbrojtjes së fëmijëve
- Aftësi shumë të mira komunikimi dhe nderveprimi në punën në grup
- Njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe
- Aftësi shumë të mira të përdorimit të kompjuterit, paketa Microsoft Word, Excel, email, etj
- Dëshirë dhe mundësi për të udhëtuar në terren

**Politikat e Mbrojtjes së Fëmijëve:** Të gjithë personat që punojnë me programet e NISMA janë të detyruar të respektojnë politikën e mbrojtjes së fëmijëve, politikën e mbrojtjes nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, kodin e sjelljes të NISMA ARSIS.

**Kohëzgjatja e ofrimit të shërbimit është përgjatë periudhës Qershor 2023 – Shkurt 2024 dhe në varësi të nevojave të identifikuara të fëmijëve dhe familjeve.**

#### **Procedura e Aplikimit:**

Aplikantët e interesuar për të aplikuar për secilin nga pozicionet e sipër shënuara duhet të dërgojnë me email

- 1- CV-në e tyre,
- 2- Letër interesi,
- 3- Letër angazhimi/disponueshmërie
- 4- Ofertën financiare.

në adresën e emailit: **[initiative.arsis@gmail.com](mailto:initiative.arsis@gmail.com)** deri në datën **27 Maj 2023**, mesnatë.

*Në vemendjen tuaj që në subjekt të emailit ku dërgohet aplikimi të vendoset: Aplikim për pozicionin e ekspertit/operator social për shërbimin e kujdesit në familje.*

#### **Procedura e Vlerësimit:**

Zgjedhja e ekspertit/grupit të ekspertëve do të bazohet në: se sa mirë aplikimi përmbush kërkesat e përcaktuara në termat e referencës, gjithashtu edhe bazuar në tabelën e vlerësimit të mëposhtëm.

<b>Kriteret e vlerësimit</b>	<b>Vlerat në %</b>
Kualifikime	30%
Eksperienca pune	50%
Oferta financiare	20%

***Ju lutem konsideroni që vetëm kandidatët e përzgjedhur për intervistë do të kontaktohen.***